



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NPT DAQA" Nexhmedin Sadiku B.I. të datës 02.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 28.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shtegut në Taukbahqe" me nr. të prokurimit 616-23-2670-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NPT DAQA" Nexhmedin Sadiku B.I. e datës 02.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 28.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shtegut në Taukbahqe" me nr. të prokurimit 616-23-2670-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues, për nënshkrim të kontratës, duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka marrë këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "NPT DAQA" Nexhmedin Sadiku B.I. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NPT DAQA" Nexhmedin Sadiku B.I. (tutje "parashtruesi") me datë 02.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 28.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shtegut në Taukbahqe" me nr. të prokurimit 616-23-2670-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë si në vijim:

Pretendimi i parë (I) – *“Mungon paisja Finisher – Ky pretendim nga ana e AK per eliminim eshte i padrejt sepse ne dosjen tonë sipas listes se kontratave poz. 1 Shkruan paisje per shtrimin e gomes se ricikluar – Paver Machine e per te cilen kemi bashkangjitur DUD R1593 ku deshmohet qe eshte paisje ne pronësi. Po ashtu AK permes Letres Standarde per Eliminim te Arsyetimi e ka cek se ka kerkuar sqarime shtese me datë 17.03.2023, por ky pretendim nuk ka te beje fare me kete aktivitet te prokurimit sepse ofertat janë dorëzuar me 24.04.2023”*.

Pretendimi i dytë (II) – *“Nuk e keni plotësuar kërkesen se keni perfunduar kontrata te natyres se ngjashme ne vlere 150,000.00 Euro së paku 1 kontrate per ndertim te shtegut. Ne kemi ofruar kontratë se bashku me Referencë: Rregullimi i parkut në Milloshevë, Palestra e sporteve, fsh. Llazarevë, vlere 247,261.36 Euro ku saktësisht te palestra e sporteve eshte i punuar shtegu i vrapimit, andaj AK na ka eliminuar padrejtësisht per kete pretendim”*.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 60 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 05.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nënparagrafit d) të RRPP.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- B05 Njoftimi për kontratë i dt. 27.03.2023.
- Dosja e tenderit e dt. 27.03.2023.
- B54 Formular Standard për korigjimin e gabimeve në njoftime e dt. 13.04.2023.
- Oferta e parashtruesit.
- B12 Procesverbali i hapjes së tenderëve i dt. 24.04.2023.
- Raporti i vlerësimit të tenderëve i dt. 27.04.2023.
- B47 Letra standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit të dt. 17.03.2023.
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 28.04.2023.
- Letra standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 28.04.2023.

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruesit sipas nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafi d) të RRPP.

- **Lidhur me pretendimin e parë** fillimisht duhet cekur që bazuar në dosjen e tenderit në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional (kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nr. 9.1&9.2) në kriterin nr. 3 përcaktohet se *“Lista e pajisjeve për ekzekutim të punimeve Finisher për shtruarjen e tartanit me pajisjen e integruar për autonivelizimin automaik”*.

Komisioni vlerësuar ka gjetur se operatori nuk ka dorëzuar dëshminë se e posedon pajisjen finisher sikurse kërkohet me dosjen e tenderit. Prandaj me datë 17.03.2023 autoriteti kontraktues ka dërguar te parashtruesi B47 Letra standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit me ç’rast është janë kërkuar sqarimet e nevojshme për këtë kriter të dosjes së tenderit. Ky fakt nuk është kontestues nga parashtruesi pasi që në kërkesën për rishqyrtim e pranon faktin se i njëjti ka pranuar një kërkesë të tillë nga autoriteti kontraktues. Megjithatë parashtruesi asnjëherë nuk ka kthyer përgjigje në këtë kërkesë të autoritetit kontraktues. As ky fakt nuk kontestohet nga parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim. Përndryshe parashtruesi në pretendim konteston faktin se në dosjen e tenderit është kërkuar të dëshmohet një pajisje e tillë. Mirëpo pas administrimit të dojes së tenderit si provë materiale në këtë rast, është gjetur se pretendimi i parashtruesit është i paqëndrueshëm. Prandaj nuk është arritur të argumentohet se gjetjet e komisionit vlerësues janë të pabazuara sikurse pretendohet nga parashtruesi. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë i parashtruesit është i pabazuar.

- **Lidhur me pretendimin e dytë** fillimisht duhet cekur që bazuar në dosjen e tenderit në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional (kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nr. 9.1&9.2) në kriterin nr. 1 përcaktohet se *“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses tri kontrata të natyrës së ngjashme në tri (3) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë)”*.

Me rastin e administrimit të ofertës së parashtruesit është gjetur se në aneksin 6 të dosjes së tenderit parashtruesi ka evidentuar vetëm një kontratë të natyrës së ngjashme (të cilën e potencon edhe në kërkesën për rishqyrtim). Mirëpo kriteri i dosjes së tenderit ka kërkuar se paku (3) kontrata të ngjashme. Për këtë arsye komisioni ka gjetur se parashtruesi nuk e plotëson këtë kriter të dosjes së tenderit. Përndryshe as vet parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim nuk e konteston faktin se ka evidentuar vetëm një kontratë në aneksin 6 të dosjes së tenderit dhe jo së paku tri sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Rrjedhimisht edhe pretendimi i dytë i parashtruesit është i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.



Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2 të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.05.2023

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komunare Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.